



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

**Datë: 18.06.2018**

Në mbështetje të nenit 53, paragrafit 3, dhe nenit 80B të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02./2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe Vendimit Nr. 05/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 25.05.2016, nenit 8 të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Ftesës Publike për mbështetje financiare të projekteve/ programeve për Ndërmjetësim në Punë për të rinj, bazuar në Vendimin Nr. 1031/2018 për formimin e Komisionit për vlerësimin e projekteve të paraqitura nga aplikuesit, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Në përputhje me detyrat dhe afatet e Komisionit të përcaktuar me vendimin e lartpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 10.05.2018, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të aplikuesëve, ku sipas kriterëve komisioni vlerësues ka shpallur fitues për subvencionim këtë Organizatë:
  1. "Kolegji European i Kosovës SH.P.K"

## A R S Y E T I M I

Komisioni për Vlerësim brenda afateve të përcaktuar ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni të dorëzuar nga Aplikuesit. Në fazën e parë në bazë të kriterëve formale administrative nga 5 (pesë) aplikues, kriteret i kanë plotësuar vetëm 2 (dy) aplikues.

Fazës së dytë të vlerësimit i janë nënshtruar 2 (dy) aplikues sipas kriterëve të thirrjes publike në komponentën e punësimit, ku komisioni ka vlerësuar secilin aplikacion në mënyrë individuale e të pavarur dhe ka vlerësuar se aplikuesi i listuar më lartë plotëson

kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe kualifikohen për të përfituar mbështetje financiare nga MKRS-ja.

Komisioni për vlerësim ka vlerësuar se 1 (një) aplikues nuk ka plotësuar kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë nuk ka marrë pikët e nevojshme për tu kualifikuar për mbështetje financiare.

Para nënshkrimit të kontratës, organizata fituese duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në organizatë dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se organizata ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda 7 ditësh, aplikimi do të refuzohet dhe nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

***Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh nga data e publikimit të këtij vendimi, nëpërmjet arkivës së MKRS-s.***

Kryesuesi i komisionit:

**Burim Mexhuani - Kryesues**


Anëtarët e komisionit:

**Besim Shala - anëtar**

**Jetmira Fetoshi - anëtare**

**Blerim Burjani - (ekspert i jashtëm, anëtar)**

**Besnik Rustemi - (anëtar nga shoqëria civile/OJQ)**



Handwritten signatures of the commission members on horizontal lines. The signatures are: Burim Mexhuani, Besim Shala, Jetmira Fetoshi, Blerim Burjani, and Besnik Rustemi.